

VAKSINIME PËR TË GJITHË

Vaksinat e Moderna kundër COVID-19

(për personat 18 vjeç e lart)

Vaksinat e Pfizer kundër COVID-19

(për personat e moshës nga 6 muajsh deri në 17 vjeç)

- + Dozat e para dhe të dyta
- + Dozat shtesë të serisë primare për personat me imunitet të cenuar
- + Injeksionet përforcuese, së bashku me injeksionin përforcues të përditësuar bivalent

Ofrohen këtu për të gjithë ata që kualifikohen

Me COVID-19 vijon të jetë më e rëndësishme se kurrë të mbroni veten dhe ata pranë jush nga sëmurja.

Vaksinat kundër COVID-19 janë të sigurta dhe tejet efikase në reduktimin e rrezikut nga sëmurja, shtrimi në spital dhe deri dhe vdekja.

Vaksinën kundër COVID-19 mund ta bëni pa shpenzime nga ana juaj.



Mësoni më tepër se cila vaksinë është e duhura për ju. Skanoni kodin QR ose telefononi në nr. **1-844-NYC-4NYC (1-844-692-4692)**.

VAKSINA KUNDËR COVID-19

Shumica e individëve gëzojnë tani të drejtën e kryerjes së një vaksine kundër COVID-19:

- + Personat e moshës 6 muaj deri 4 vjeç mund të bëjnë tri doza pediatrike (një e dhjeta e fuqisë) së Pfizer-BioNTech
- + Personat e moshës 5 deri 11 vjeç mund të bëjnë dy doza pediatrike (një e treta e fuqisë) së Pfizer-BioNTech
- + Personat nga 12 vjeç e lart mund të bëjnë dy doza të vaksinës Pfizer-BioNTech
- + Personat nga 18 vjeç e lart mund të bëjnë dy doza të vaksinës së Moderna

Dozat shtesë të serisë primare të vaksinës së Pfizer dhe të Moderna

Dozat shtesë të serisë primare të vaksinës mRNA preferohen për personat që kanë sistem të dobësuar imunitar për shkak të ndonjë sëmundjeje apo trajtimi.

Dozat shtesë të serisë primare nuk rekomandohen për shumicën e njerëzve me probleme të tjera mjekësore, si p.sh. diabet, sëmundje të zemrës apo të mushkërive.

Doza përforcuese kundër COVID-19 - Marrësit e vaksinave Pfizer dhe Moderna

Fëmijët e moshës 5-11 vjeç që kanë bërë më parë serinë primare të Pfizer mbi pesë muaj më parë përfitojnë vetëm injeksionin përforcues monovalent të Pfizer.

Për personat e moshës 12 vjeç e lart, injeksioni i vetëm përforcues i autorizuar është injeksioni përforcues i përditësuar bivalent. Personat e moshës 12 vjeç e lart nuk mund ta marrin më injeksionin përforcues monovalent origjinal.

Personat e moshës 12 vjeç e lart duhet të marrin një dozë të injeksionit përforcues të përditësuar bivalent të paktën dy muaj pas serisë së tyre primare të vaksinave kundër COVID-19 ose injeksionit të fundit përforcues.

Të vaksinuarit mund të kryejnë të njëjtën vaksinë që kanë bërë fillimisht si serinë e tyre primare të vaksinës ose si injeksionin përforcues të mëparshëm, ose mund të kalojnë te cilido nga dy llojet e tjera të vaksinave.